



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 27

Datë: 19. 10. 2022. Ora: 13: 30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: , drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 26/2022**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

1.Rekomandim për pezullim të partisë politike “Ujedinjena Stranka Bošnjaka”

- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

1.Këshilli për Personel

1.1. Njoftim lidhur me pozitat e lira në SKQZ

1.2. Rekomandim lidhur me ri sistemimin e drejtorit aktual të ZRPPC-së në SKQZ

1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.01/2022, për procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorit të zyrës për regjistrim, certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike

2.Këshilli për Çështje Ligjore:

1.1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Podujevë.

1.2.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ Nr.xx/2022 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

3.Këshilli për Buxhet dhe Financa

3.1.Njoftimi me Qarkoren buxhetore 2023/02 dhe buxhetin e KQZ-së për vitin 2023;

3.2.Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Departamentit të Teknologjisë Informative

3.3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nëntëmujor financiar për periudhën 1 Janar - 30 shtator 2022

3.4.Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për punëtorinë “Identifikimi i Shtyllave dhe Synimeve Strategjike”

4.Këshilli për Operacione Zgjedhore;

4.1.Shqyrtimi dhe miratimi i Analiza gjinore dhe moshës së lidërshipt të partive politike 2017-2021

4.2.Shqyrtimi dhe miratimi i draft projekti “Punëtorja për përmirësimin e Listës së Votuesve”

6.Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së Sekretariatit të ish Asociacionit të zyrtarëve zgjedhor Evropian

7.Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së “Transparency International”

8.Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Përshëndetje. Presnet jemi të gjithë, veç z. Hamiti. Kryetari Radoniqi, paraqiti para anëtarëve të KQZ –së rendi e ditës. Në vazhdim, anëtari Alim Rama, pati vërejtje në renditjen e pikave të agjendës, kurse z. Arianit Elshani, kërkoi që pika “Shqyrtimi dhe miratimi i Analiza gjinore dhe moshës së lidërshipt të partive politike 2017-2021”, të largohet nga rendi i ditës dhe të shtyhet për mbledhjen e radhës sepse, edhe KQZ ka kërkuar disa ndërhyrje, plotësime.

Kryeshefi z. Ahmetaj, propozoi që KQZ sot të vendosë sot se kush do ta përfaqësoj në takimin “on line” të ish Zyrtarëve të Asociacionit Evropian të Zgjedhjeve meqë takimi mbahet sot, ndërsa po ashtu, ai e informoi KQZ –në për një ftesë të pranuar nga “International Republica Istitut” ku janë të ftuar kryetari dhe kryeshefi i KQZ, kështu që edhe kjo temë, ai propozoi të trajtohet. Kurse, Ilir Gashi propozoi që pika rreth Këshillit për Personel të jetë e fundit, meqë aty diskutohen çështje që, mund të diskutohen vetëm mes anëtarëve të KQZ-së.

Me këto propozime, dhe plotësime, anëtarët e KQZ-së miratuan me 10 vota për rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 26/2022.

Anëtarët e KQZ, propozuan që ky procesverbal të shtyhet për miratim në mbledhjen e radhës, në mënyrë që të inkorporohet edhe pjesa me: “dyer të mbyllura”.

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në takimin “on line” të ish Zrtarëve të Asociacionit Evropian të Zgjedhjeve (ish ACEEO).

Burim Ahmetaj, informoi për ftesën dhe pjesëmarrjen online në takimin që mbahet nga ora 2:30 deri në ora 3:30, kurse anëtarët e KQZ-së u dakorduan që në këtë takim përfaqësimi të bëhet nga kryetari Kreshnik Radoniqi.

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Valmira Selmani, zyrtare e ZRPP-së, paraqiti raportin lidhur me arsyet e rekomandimit të zyrës për pezullim të partisë politike “Ujedinjena Stranka Bošnjaka”.

Pas dëgjimit të raportit, anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për miratuan këtë rekomandim të zyrës.

Ky subjekt, ka kohë prej 45 ditësh që ta organizoj dhe mbaj kuvendin dhe ta njoftojnë zyrën.

Në këtë pikë, Alim Rama, tha se 'ka qenë shqetësues një raport i nënshkruar i dalë në media për listën "Guxo". Ai tha se, raporti ka qenë deskriptiv, dhe nuk ka ardhë tek ne, dhe raporti ka dalë në media, e kjo është shqetësuese dhe lëshim i zyrës...

Të njëjtin shqetësim, e shprehu edhe z. Sami Kurteshi...

5.Këshilli për Çështje Ligjore:

1.1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Podujevë:

Sami Kurteshi, paraqiti kërkesën nga ky këshill për zëvendësim. Adelina Stublla, si asambleiste e Kuvendit të Komunës së Besianës nga subjekti politik Lëvizja "Vetëvendosje!" ka dhënë dorëheqje për shkak të angazhimit tjetër, dhe zëvendësohet nga Lirika Maçliqi, sipas radhës...

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për miratuan këtë zëvendësim.

1.2.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ Nr.xx/2022 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

Sami Kurteshi, e informoi KQZ-në lidhur me hartimin e dokumentit: "Udhëzimi Administrativ Nr.xx/2022 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve". Ai tha se, ky dokument është trajtuar nga këshilli dhe se rekomandohet për miratim, eventualisht me vërejtjet që mund të shfaqen nga anëtarët...

Në këtë pikë, diskutoi Arianit Elshani, që tha se ky është një përkushtim rreth një udhëzimi të munguar, kurse z. Rama tha se dokumentit i mungojnë përshkrimet se cilat janë pasuritë financiare, kurse z. Kurteshi tha se këtu mungojnë "shprehjet dhe përkufizimet"...

Anëtarët e KQZ-së me 10 vota për miratuan këtë udhëzim administrativ.

6.Këshilli për Buxhet dhe Financa

3.1.Njoftimi me Qarkoren buxhetore 2023/02 dhe buxhetin e KQZ-së për vitin 2023:

Illir Gashi, tha se në mbledhjen e 11 janë trajtuar pikat katër pika. Në pikën e parë, këshilli është informuar lidhur me shkurtime në kërkesa tona buxhetore dërguar nga KQZ ministrisë së Financave. Ne, rekomanduam që edhe njëherë t'i dërgohet kërkesa sepse, asnjë cent nga kërkesat tona nuk është miratuar, sepse është një shifër simbolike: rreth 150 mijë euro, nëse nuk gaboju...

Pse nuk ka ndodh kjo, ne nuk e dimë. Ky është veq njoftim, tha z. Gashi. Anëtarët e KQZ-së folën rreth kësaj pike më gjatë, analizuan relacionet e shpenzimeve, kodet buxhetore, shtruan pyetje etj. (Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, Čemailj Kurtiši, Arianit Elshani dhe Miradije Meha, drejtoresh e DAP-it).

3.2.Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Departamentit të Teknologjisë Informative:

Illir Gashi, e informoi KQZ-në edhe rreth shqyrtimit të kërkesës buxhetore të departamentit të IT-së, dhe tha se këshilli ka aprovuar kërkesën e këtij departamenti rreth ndryshimit të buxhetit nga kategoria ekonomike. Lidhur me detajet e kësaj kërkesë, informoi në detaje drejtoresha Miradije Meha.

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për këtë kërkesë.

3.3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nëntëmujor financiar për periudhën 1 Janar - 30 shtator 2022:

Illir Gashi, e informoi KQZ-në rreth miratimit të këtij raporti nga këshilli, dhe rekomandimin për aprovimin e tij.

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për e miratuan këtë raport.

3.4.Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për punëtorinë “Identifikimi i Shtyllave dhe Synimeve Strategjike”:

Illir Gashi, raportoi rreth kësaj pike të shqyrtuar nga këshilli lidhur me mbajtjen e punëtorisë: “Identifikimi i Shtyllave dhe Synimeve Strategjike”, dhe tha se këshilli e ka rekomanduar për miratim.

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për e miratuan buxhetin lidhur me mbajtjen e kësaj punëtorie.

7.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

4.1. Shqyrtimi dhe miratimi i draft projekti “Punëtorja për përmirësimin e Listës së Votuesve”:

Arianit Elshani, tha se KOZ rekomandon që të aprovohet kjo kërkesë për një draft – projekt për organizimin e një punëtorie për përmirësimin e Listës së Votuesve të KQZ në koordinim me institucionet tjera si ARC dhe departanete e tjera nga Ministria e Brendshme.

Z. Elshani, shpjegoi rëndësinë e mbajtjes së kësaj punëtorie, rolin që ka lista votuese, besueshmërinë, verifikimin dhe pastrimin e listës etj. Veç pjesëmarrjes së Sekretariatit, Elshani tha se anëtarët e KQZ-së duhet të jenë, dhe ai tha se pesë anëtarë do t’ishte optimale të marrin pjesë në këtë punëtori.

Në këtë pikë, diskutoi Sami Kurteshi, i cili shprehi gatishmërinë për të marrë pjesë, ndërsa kryetari Radoniqi, tha se cili që dëshiron nga anëtarët e KQZ-së, le të marrë pjesë...

Në fund, anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, miratuan këtë draft – projekt.

Kreshnik Radoniqi: Tani, ju njoftoj se kemi pranuar tri ftesa. Ftesat janë për mua, Niten dhe Megin. Nita është si zëvendësim i zyrtareve të tjera të cilat nuk mund të shkojnë, kjo s’ka të bëjë me Sekretariat por me zyrën. Ftesa është nga “Transparency International” nga Çekia. Pjesëmarrës është edhe KDI, diçka tjetër s’ka...!

Na duhet një miratim, sidomos nëse ka ndonjë shpenzim.

Arianit Elshani, po e ngris një çështje që ka të bëjë me një takim të organizuar nga IFES në Tiranë, mendoj që është me 14 ose 15 nëntor... Unë, në këto data nuk mund të marrë pjesë dhe e liroj vendin për shkak të planifikimeve tjera...

Kreshnik Radoniqi, tha se ua kemi dërguar një imell por, është në gjuhën angleze...Mirë, po bëjmë pauzë...

1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.01/2022, për Procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorit të zyrës për regjistrim, certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike:

Alim Rama: E kemi një draf – propozim nga këshilli, por dje kemi pranuar edhe disa komente nga zyra britanike. Mendoj që duhet ta shqyrtojmë nen për nen këtë rregullore, dhe të jemi sa më ekspeditiv.

Sami Kurteshi, pyeti se pse është kaq shpejtë...?

Kreshnik Radoniqi: Nesër duhet ta shpallim konkursin...! E kemi obligim ligjorë...!

Sami Kurteshi, tha se ka marrë një imell, por s'ka mundur të përgatitet për shqyrtimin e kësja pike. Ne, nuk kemi rregullore dhe ta shpallim konkursin të cilin, ndoshta mund ta shpallim edhe me rregulloren e vjetër...Pashë edhe disa vërejtje – komente të ambasadës britanike, por kam frikë që nuk do të mundemi ta shqyrtojmë si duhet...

Arianit Elshani, tha se komentet e ambasadës britanike janë, dy – tri...Do të doja të jetë edhe Alberti, por sido qoftë, ne, ndoshta e përditësojmë dhe rekomandimet e UNDPA-së janë të përfshira...

Në vazhdim, Sami Kurteshi, Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi dhe Čemailj Kurtiši shtruan pyetje, komente, sugjerim dhe çështje të tjera për dhe kundër mundësisë së shqyrtimit dhe miratimit të ligjit. Anëtarët e KQZ-së pastaj, në bashkëpunim edhe me pjesëmarrësit e tjerë prezent, pas një analize të gjatë përmbajtësore të tekstit, që prej “preambulës” dhe te të gjitha nenet, e anëtarët e KQZ-së e miratuan:

Me 9 vota për Rregulloren Nr.01/2022, për Procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorit të zyrës për regjistrim, certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike.